VENDIM
Nr. 59, datë 23.1.2013

PËR HEQJEN NGA FONDI KULLOSOR TË SIPËRFAQEVE NË NGASTRAT E EKONOMISË KULLOSORE "DHËMBEL", PËRMET, QË DO TË PËRDOREN NGA SHOQËRIA "FLUTONE" SHPK, PËR KARIERË GURI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të pikës 1 të nenit 10 të ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Heqjen nga fondi kullosor kombëtar të sipërfaqeve në ngastrat 20 dhe 24, të ekonomisë kullosore "Dhëmbel", Përmet, që do të përdoren nga subjekti "Flutone" sh.p.k., për karrierë guri, dhe çregjistrimin nga zëri kadastral "kullotë" të sipërfaqes prej 7 (shtatë) ha, sipas tabelës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, pasi të përcaktohen në terren dhe në hartë kufijtë e rinj të fondit kullosor kombëtar, që rezultojnë nga heqja e sipërfaqeve të këtyre ngastrave, sipas pikës 1 të këtij vendimi, bën çregjistrimin e saj nga kategoria "tokë e zënë, kullotë" dhe e regjistron në sipërfaqe inproduktive për veprimtari minerare, në zbatim të pikave 10 e 11 të vendimit nr. 1374, datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave "Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor".

3. Vlera e sipërfaqes kullosore të hequr dhe e infrastrukturës së saj paguhet nga subjekti "Flutone" sh.p.k., sipas lidhjes nr. 4 të vendimit nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave".

4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, subjekti "Flutone" sh.p.k., brenda 2 (dy) viteve, me fondet e veta do të përmirësojë 7 (shtatë) ha kullota në ngastrat e përcaktuara nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor Përmet. Mënyra e përmirësimit, deri në marrjen në dorëzim me procesverbal të sipërfaqes së përmirësuar, do të bëhet sipas marrëveshjes që do të lidhet ndërmjet palëve me kërkuesin.

5. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha